



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

RREGJISTRI I KËRKESAVE PËR INFORMACION

Periudha Prill-Qershor 2025

Nr rendor (1)	Data e kërkesës (2)	Objekti i kërkesës (3)	Data e përgjigjes (4)	Përgjigje (5)	Mënyra e përfundimi t të kërkesës (6)	Tarif a (7)
1	28.04.2025	1. Kërkojmë të vihemi në dispozicion me një listim të plotë të subjekteve apo personave fizikë të kontraktuar nga Bashkia Himarë për të shfrytëzuar zonat e plazheve në të gjithë territorin e saj duke përfshirë dhe njësitë administrative bregdetare – ndarë sipas kolonave me këto karakteristika: a. emri i subjektit/NIPT-i/Adresa ose vendndodhja e plazhit në shfrytëzim/kohëzgjatja e kontratës; b. në variantin kur janë persona emri mbiemri personit/Adresa ose vendndodhja e plazhit nëshfrytëzim/kohëzgjatja e kontratës. 2. Një kopje të kontratave që ka bashkia juaj në zotërim për hapësirat detare, të rërës	09.05.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 28.04.2025, ardhur me postë elektronike, me objekt “Kërkesë për informacion” drejtuar Bashkisë Himarë, ju sqarojmë sa më poshtë: Bashkia Himarë është përfituese në kontratat për stacionet e plazhit. Këto kontrata lidhen nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, pranë Ministrisë së Turizmit. Aktualisht, kontratat për sezonin veror 2025 janë në proces dhe ende nuk ka një listë përfundimtare. Sa i përket pyetjes së dytë, ju informojmë se nuk ka asnjë shoqëri aksionare që menaxhon plazhet publike apo private në territorin e Bashkisë Himarë.	Përfunduar	Jo

		dhe të plazheve në qytetin tuaj; 3. A keni ndonjë shoqëri aksionare apo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila menaxhon këto plazhe publike apo private? 4. Nse po, si funksionon? 5. Nëse po, pse keni zgjedhur pikërisht këto shoqëri për dhënien e të drejtës dhe caktimin e përgjegjësisë së menaxhimit, administrimit dhe mirëmbajtjes së plazheve publike? 6. Nëse po, sa sipërfaqe të menaxhimit të plazheve publike apo private kanë nën administrim këto shoqëri?		Ju falënderojmë për interesimin dhe jemi në dispozicion për çdo informacion të mëtejshëm.		
2	02.06.2025	Lidhur me investimin e nisur në prill të vitit 2023 për të ndërtuar një urë në fshatin Kallarat të Njësisë Administrative Horë-Vranisht, kërkojmë të dimë: • A ka pasur një projekt të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak për ndërtimin e kësaj ure? Nëse po, mund të na e vini në dispozicion? • A është zhvilluar një procedurë prokurimi për këtë qëllim? • Cila ka qenë firma e kontraktuar për ndërtimin e urës?	13.06.2025	Në përgjigje të shkresës suaj me objekt “Kërkesë për informacion në lidhje me investimin e nisur në muajin Prill të vitit 2023, për ndërtimin e një ure në fshatin Kallarat, Njësia Administrative Horë-Vranisht, ju bëjmë me dije si më poshtë: 1.Në lidhje me çështjen “A ka pasur një projekt të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak për ndërtimin e kësaj ure? Nëse po, mund të	Përfunduar	Jo

		• Sa ka qenë fondi i realizimit të punimeve dhe të kujt janë këto para (qeverisë/Bashkisë/donacione)? • Pse ura nuk ka përfunduar pas 2 vjetësh nga nisja e punimeve? • Kur do të përfundojë?		na e vini në dispozicion?” Nuk ka pasur asnjë “projekt teknik” të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak për ndërtimin e kësaj ure. Konkretisht ka pasur vetëm një fond të miratuar nga Këshilli Bashkiak, i cili për shkak të procedurave administrative dhe afateve përkatëse nuk është arritur të realizohet. 2.Në lidhje me çështjen “A është zhvilluar ndonjë procedurë prokurimi për ndërtimin e urës?” Nuk është zhvilluar asnjë procedurë prokurimi për këtë qëllim, siç sqarohet më sipër. 3.Në lidhje me çështjen “Cila ka qenë firma e kontraktuar për ndërtimin e urës?” Nuk ka asnjë firmë të kontraktuar për ndërtimin e urës. 4.Në lidhje me çështjen “Sa ka qenë fondi i realizimit të punimeve dhe të kujt janë këto para (qeverisë, Bashkisë, donacione)?”	
--	--	---	--	--	--

				Nuk ka fonde të “realizuara” për këtë punim nga asnjë burim (as nga qeveria, Bashkia apo donacione). 5.Në lidhje me çështjen “Përse ura nuk ka përfunduar pas 2 vjetësh nga nisja e punimeve?” Prokurimi për këtë investim nuk është kryer, siç sqarohet më sipër. 6.Në lidhje me çështjen “Kur do të përfundojë realizimi i urës?” Punimet e referuara në kërkesën tuaj nuk kanë filluar ende, por Bashkia Himarë mbetet e angazhuar në ndjekjen e të gjithë hapave ligjorë dhe administrative për realizimin e projekteve që i shërbejnë komunitetit.		
3	19.06.2025	1. Kërkojmë të vihem në dispozicion me një listim të plotë të subjekteve apo personave fizikë	23.06.2025	Përsëhendetje! Përgjigje ndaj kërkesës për informacion mbi kontraktimet	Përfunduar	Jo

	të kontraktuar nga Bashkia Himarë për të shfrytëzuar zonat e plazheve në të gjithë territorin e saj duke përfshirë dhe njësitë administrative bregdetare – ndarë sipas kolonave me këto karakteristika: a. emri i subjektit/NIPT-i/Adresa ose vendndodhja e plazhit në shfrytëzim/kohëzgjatja e kontratës; b. në variantin kur janë persona emri mbiemri personit/Adresa ose vendndodhja e plazhit nëshfrytëzim/kohëzgjatja e kontratës. 2. Një kopje të kontratave që ka bashkia juaj në zotërim për hapësirat detare, të rërës dhe të plazheve në qytetin tuaj; 3. A keni ndonjë shoqëri aksionare apo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila me-naxhon këto plazhe publike apo private? 4. Nse po, si funksionon? 5. Nëse po, pse keni zgjedhur pikërisht këto shoqëri për dhënien e të drejtës dhe cakti-	për shfrytëzimin e zonave bregdetare Në vijim të emailit tuaj, ju informojmë si më poshtë: Lidhur me subjektet kontraktuese për stacione plazhi për vitin 2025: Aktualisht procesi për përzgjedhjen e subjekteve që do të ushtrojnë veprimtari në zonat e plazhit për sezonin turistik 2025 është ende në zhvillim. Ky proces rregullohet nga: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 649, datë 16.10.2024 (i ndryshuar), si dhe VKM nr. 251, datë 30.04.2025, i cili shtyu afatin e aplikimeve deri në fund të muajit qershor 2025. Duke qenë se procesi është ende në vijim, nuk është finalizuar ende lista përfundimtare e subjekteve që do të ushtrojnë veprimtarinë si stacione plazhi për këtë sezon.	
--	---	---	--

		min e përgjegjesisë së menaxhimit, administrimit dhe mirëmbajtjes së plazheve pu-blike? 6. Nëse po, sa sipërfaqe të menaxhimit të plazheve publike apo private kanë nën admi-nistrim këto shoqëri?		Pas përfundimit të procesit, lista do të publikohet në faqen zyrtare të AKB-së. Ju sqarojmë se: Përzgjedhja, shqyrtimi dhe kontraktimi i subjekteve bëhet nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB), përmes Grupit Teknik të Shqyrtimit të Aplikimeve (GTSHA), në bashkëpunim me bashkitë përkatëse. Bashkia Himarë nuk është autoriteti kontraktues, por ofron mbështetje teknike dhe administrative në këtë proces. 3. Për sezonet e mëparshme: Të gjitha kontratat dhe listat e subjekteve të miratuara për sezonet e kaluar janë të publikuara nga AKB në faqen zyrtare: 🔗 https://bregdeti.gov.al/stacione-plazhi Për çdo informacion shtesë mbi kontratat e mëparshme, ju	
--	--	--	--	---	--

				rekomandojmë të referoheni drejtpërdrejt te publikimet e AKB-së, që është autoriteti përgjegjës. Bashkia Himarë mbetet e angazhuar për të garantuar transparencë dhe bashkëpunim të plotë me median dhe organizatat e shoqërisë civile, konform ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. 4. Lidhur me ekzistencën e ndonjë shoqërie që menaxhon plazhet publike apo private: Bashkia Himarë nuk disponon ndonjë shoqëri aksionare apo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për menaxhimin e plazheve publike apo private në territorin e saj. Por Bashkia Himarë ka krijuar Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike Himarë (NSHP), një njësi në varësi të saj, përmes vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 45, datë 16.12.2024. Kjo ndërmarrje		
--	--	--	--	--	--	--

				është përgjegjëse për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e disa hapësirave publike, përfshirë zona të plazheve publike. Menaxhimi i zonave private bregdetare bëhet përmes: subjekteve private që aplikojnë pranë Agjencisë Kombëtare të Bregdetit (AKB) për të marrë të drejtën e përkohshme të përdorimit për sezonin turistik; Përzgjedhja e subjekteve private për menaxhimin e segmenteve të plazhit, sipas procedurës së rregulluar me VKM nr. 649/2024dhe VKM nr. 251/2025, kryhet nga AKB nëpërmjet Grupit Teknik të Shqyrtimit të Aplikimeve.		
--	--	--	--	---	--	--

Shënim:

- 1-Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve**
- 2-Data e regjistrimit të kërkesë**
- 3-Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi**
- 4-Data e kthimit të përgjigjes**
- 5-Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi**
- 6-Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar**
- 7-Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.**